

Të nderuar pjesëmarrës në konferencë më lejoni ta shpall të hapur këtë konferencë me titull Multikonfesionalizmi në shoqërinë multietnike dhe multikonfesionale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Konferenca ishte planifikuar të mbahet në lokalet e FSHI-së, por për shkak të situatës me pandeminë jemi të detyruar ta mbajmë online.

Të nderuar pjesëmarrës mirë se vini në FSHI, ku disa nga ju keni njohuri për FSHI-në RMV, u ky fakultet mision të vetin ka krijimin, përcjelljen, mbrojtjen e dijeve, nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbimeve dhe formimit të specialistëve të lartë në fushat e studimeve islame, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. Vizioni ynë është të ndërtojmë një fakultet modern, të fokusuar drejt së ardhmes, të vlefshëm për shoqërinë tonë multietnike dhe multifetare, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend, si edhe në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal. Prandaj, uroj që lirshëm të këmbeni mendime dhe ide të argumentuara shkencore për një temë shumë të rëndësishme siç janë multikonfesionalizmi dhe multikulturalizmi, të cilët janë dhe mbeten pasuri dhe mbështetje për njëra-tjetrën dhe e bëjnë të veçantë një shoqëri, prandaj kjo pasuri duhet të kultivohet edhe në të ardhmen.

Islami dhe Krishterimi, dy nga fetë më të mëdha të trashëgimisë abrahamike, kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në qytetërimin njerëzor. Prandaj, angazhimi i komunitetit fetar islam këtu në RMV ka promovuar një angazhim të përbashkët ndaj vlerave universale të drejtësisë sociale, barazisë, të mirës së përbashkët, mirëqenies sociale, pjesëmarrjes politike, lirisë fetare dhe një mori parimesh e vlerash të tjera të përbashkëta. Duke pasur parasysh klimën politike dhe shoqërore moderne në botë, është më e rëndësishme se kurrë më parë të diskutohet mbi kontributet e qytetërimeve, me qëllim të ndërtimit të urave të vlerësimit dhe mirëkuptimit midis popujve të kulturave dhe ideologjive të ndryshme. Për të sjellë paqe të sinqertë në këto hapësira, ne duhet të ringjallim pastërtinë e pacenuar dhe frymën e barazisë monoteiste dhe të drejtësisë për të gjithë. Duhet të sigurohemi që këto vlera shpirtërore të kthehen në fuqi për t'i sjellë njerëzit në kuptimet e tyre.

Edhe njëherë, uroj të kaloni mirë në këtë konferencë, të njihemi në mes veti, të këmbejmë ide e mendime të argumentuara shkencërisht, por edhe të hapim rrugë bashkëpunimit tonë në hapësirat ballkanike, evropiane e botërore.

Ju faleminderit!

Assoc. Prof. Dr.sc. Shaban Sulejmani

Dekani i Fakultetit të Shkencave Islame